



KONTRATE PER KALIMIN E

KUOTES SE KAPITALIT

Sot, me 30 Tetor 2017, (dymije e shtatembdhjete), ditën e Heue^{9 4}, perpara meje noteres Donika Gjini ne zyren time ne adresen Blv.B.Curri, Tirane, u paraqiten palet e meposhtme:

Genci HAFIZI, i lindur me 10-02-1958 ne Lezhe, i biri i Ramiz-it, banues ne Shkoder, Rr. "Qemal Dracini", L. "Vasil Shanto", Pallati prane diskotekes, mbajtes i leternjoftimit nr.024584722, madhor dhe me zotesi te plote per vepruar (*ketu e me poshte ne kete Kontrate referuar si "Shitesi"*).

Alma HAFIZI, e lindur me 22-06-1969 ne Shkoder, e bija e Zija-se, banuese ne Shkoder, Rr. "Qemal Dracini", L. "Vasil Shanto", Pallati prane diskotekes, mbajtese e leternjoftimit nr.024584170, madhor dhe me zotesi te plote per vepruar (*ketu e me poshte ne kete Kontrata ne cilesine e bashkeshortes se Shitesit*).

Hasan HAFIZI, i lindur me 11-02-1955 ne Lezhe, i biri i Ramiz-it, banues ne Tirane, Rr. "Sami Frasheri, P.19/1" mbajtes i leternjoftimit nr.029055631, madhor dhe me zotesi te plote per vepruar (*ketu e me poshte ne kete Kontrate referuar si "Bleresi"*);

"Genci HAFIZI" dhe "Alma HAFIZI" si dhe "Hasan HAFIZI" ketu e me poshte ne kete Kontrate Per Kalimin e Kuotes se Kapitalit (*ketu e me poshte ne kete Kontrate referuar si "Kontrata"*), se bashku do te referohen ne vijim si "Palet".

MEQENESE

- A. Shitesi zoteron 25 kuota (ose 25% te perqindjes se pjesemarrjes) (me poshte "Kuotat e Shitesit") ne kapitalin e KARL GEGA KONSTRUKSION SHPK., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, regjistruar me nr. NIPT-i J66703076W ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Republikes se Shqiperise, me seli ne Shkoder, Lagjia "Ndoc Mazi", perballe Konviktit "Safet Spahia" (me poshte e quajtur "Shoqeria").
- B. Shitesi deshiron te kaloje pronesine mbi te gjitha Kuotat e Shitesit te identifikuara ne paragrafin (A) me sipër, dhe Bleresi i pranon ato.

Ne konsiderate te sa me lart, Palet bien dakort per sa vijon:

NENI 1

KALIMI I PRONESISE

- 1.1 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesi i kalon Bleresit dhe Bleresi pranon nga Shitesi te gjitha Kuotat e Shitesit dhe çdo te drejte te lidhur me to dhe/ose qe rrjedh prej tyre.
- 1.2 Me nenshkrimin e Kontrates, pronesia mbi te gjitha Kuotat e Shitesit dhe te drejtat e tjera qe lidhen me to dhe ose rrjedhin prej tyre, perfshire te drejten e votes dhe te dividendit ne Shoqeri i kalojne Bleresit dhe Shitesi zhvishet teresisht prej tyre.

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES

- 2.1 Palet bien dakort qe marredheniet financiare ne lidhje me kalimin e pronesise se kuotes se Shitesit jane rregulluar sipas Akt Marreveshjes qe Palet kane lidhur ndermjet tyre.

NENI 3

DEKLARIME DHE GARANCI

- 3.1 Shitesi deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe per Shitesin.
- 3.2 Bleresi deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe per Bleresin. Gjithashtu, Bleresi i pranon Kuotat e Shitesit objekt i kesaj Kontrate ne gjendjen te cilat ato jane dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje me to apo te drejta qe lidhen me to dhe/ose rrjedhin prej tyre.

NENI 4

TE NDRYSHME

- 4.1 Secila prej paleve do te perballoje shpenzimet e veta ne lidhje me negocimin, nenshkrimin dhe permbushjen e detyrimeve te parashikuara ne kete akt.
- 4.2 Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet personalisht nga palet e kesaj Kontrate apo perfaqesues te autorizuar rregullisht prej seciles nga palet ne fjale.

NENI 5


LIGJI ZBATUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

- 5.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete akt apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.


5.2 Çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis paleve të këtij akti në lidhje me zbatimin apo interpretimin, nëse nuk zgjidhet në mirekuptim mes vete paleve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Une Noteri, e lexoj tekstin e këtij akti me ze të lartë dhe të kuptueshëm paleve të cilet, pasi me deklaruan se teksti i këtij akti është në përputhje të plotë me theniet dhe vullnetin e tyre, e nënshkruajmë atë rregullisht në praninë time në 4 (katër) origjinale me vlerë të njëjtte secili, dhe une Noteri vërtetoj sa më sipër sipas ligjit në fuqi.

BLERESI


Hasan HAFIZI

SHITESI


Genci HAFIZI

Dha Pelqimin


Alma HAFIZI

NOTER


DOMIKA GJINI